



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TIRANË

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E RRUGËVE DHE NDRIÇIMIT PUBLIK

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Datë 30/09/2020

Nga: Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe Ndrëçimit Publik.

Drejtuar: Operatorit ekonomik “Luar Bros” sh.p.k, me NUIS L72322004M, me adresë: Blv.Gjergj Fishta,Qendra Alpas, Shk.2 , Kati2, Ap nr.1, Tiranë

Procedura e prokurimit: Kërkesë për propozim.

Numri i referencës së procedurës: REF-70176-08-28-2020.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje materiale ndihmëse për ndriçimin publik”,
afati: brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga nënshkrimi i kontratës.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët **X** oferta ekonomikisht më e favorshme

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike Nr. 66, Date 08.09.2020.

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “SARK” sh.p.k.,me NUIS K52531415H, me ofertë ekonomike 846.000 (tetëqind e dyzetë e gjashtë mijë) lekë pa tvsh.
2. Operatori ekonomik “Luar Bros” sh.p.k me NUIS L72322004M, me ofertë ekonomike 1.122.000 (një milion e njëqind e njëzet e dy mijë) lekë pa tvsh.
3. Operatori ekonomik “ALIA” sh.p.k me NUIS J67902247B, me ofertë ekonomike 1.221.000 (një milion e dyqind e njëzet e një mijë) lekë pa tvsh.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

I. “SARK” sh.p.k, me NUIS K52531415H

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Nuk përmbush pikën 1, shkronja dh, të kritereve të veçanta të kualifikimit ku është parashikuar se "*Ofertuesi duhet të dorëzojë:dh).Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë, që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*".

Operatori ekonomik ka paraqitur “Vërtetim debie për operatorët ekonomik për pjesëmarrje në procedurat e prokurimit publik...”, me Nr. 746 Prot, datë 28.07.2020, lëshuar nga Furnizuesi i Shërbimit Universal, përfshirë pagesën e muajit qershor 2020. Duke qenë e data e hapjes së tenderit ishte më 10.09.2020 , operatori duhet të paraqiste vërtetim debie ku të përfshihej pagesa e muajit korrik, pasi detyrimi i energjisë elektrike të muajit korrik konsiderohet detyrim i maturuar më datë 10.09.2020.

2.Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se "*Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.*"

Operatori ekonomik “SARK” sh.p.k nuk ka paraqitur autorizim prodhuesi ose nga distributor i autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi siç janë: tub hekuri, tub zingato, qafore ABC, tirand ABC dhe shirit tokëzimi.

Operatori ekonomik ka paraqitur vetëm dy autorizime si mëposhtë vijon:

- Autorizim nga shoqëria “Sali Elektrik” sh.p.k , lëshuar më datë 17.03.2017 për kablllo të seksioneve të ndryshme
- Autorizim nga shoqëria “Sali Elektrik” sh.p.k , lëshuar më datë 02.03.2018 për ndriçues.

Duke qenë se kabllo dhe ndriçuesit nuk janë mallra objekt prokurimi, autorizimet e mësipërme nuk janë të vlefshme për këtë procedurë prokurimi.

3. Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku parashikohet se “*Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallin objekt prokurimi, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.*”

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur katalog dhe/ose skeda teknike për mallrat objekt prokurimi siç janë tub hekuri, tub zingato, qafore ABC, tirand ABC dhe shirit tokëzimi.

II. “ALIA” sh.p.k, me NUIS J67902247B

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1.Nuk përmbush pikën 1, shkronja dh, të kritereve të veçanta të kualifikimit ku është parashikuar se "*Ofertuesi duhet të dorëzojë:dh).Vërtetimin që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë, që ka*

operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.” pasi nuk ka paraqitur dokumentacion për plotësimin e kësaj pike.

2.Nuk përmbush pikën 2.3.2 të kapacitetit teknik ku parashikohet se " *Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar për mallrat, objekt prokurimi. Në rast se paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet distributorit të autorizuar dhe prodhuesit. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.* " pasi nuk ka paraqitur autorizim nga prodhuesi ose nga distributori i autorizuar nga prodhuesi për tub hekuri dhe tub zingato.

3.Nuk përmbush pikën 2.3.4 të kapacitetit teknik ku parashikohet se " *Operatori ekonomik duhet të paraqesë për mallin objekt prokurimi, katalogun dhe/ose skedat teknike të botuara nën autoritetin e prodhuesit, që nënkupton se duhet të jenë me logon e tij dhe ku jepen të gjitha karakteristikat teknike të këtyre materialeve me qëllim që autoriteti kontraktor të verifikojë përmbushjen e specifikimeve teknike.* " pasi nuk ka paraqitur katalog dhe/ose skeda teknike për mallin objekt prokurimi siç janë tub hekuri dhe tub zingato.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë Operatorin Ekonomik "**Luar Bros**" sh.p.k, me NUIS L72322004M, me adresë: Blv.Gjergj Fishta, Qendra Alpas, Shk.2 , Kati 2, Ap nr.1, Tiranë dhe me ofertë ekonomike 1.122.000 (një milion e njëqind e njëzet e dy mijë) lekë pa tvsh, është identifikuar si ofertë e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik, Rruga "5 Maji", Tiranë sigurimin e kontratës siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve që nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar.

Njoftimi i klasifikimit është bërë në datë 22.09.2020.

Ankesa: Nuk ka.